

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Mihrie Krasniqi-Sheholli dhe bashkëpunëtorit profesional Izet Hyseni në çështjen penale kundër të akuzuarëve M.A. dhe A.A. që të dy me vendbanim në rr. "...", Komuna e P. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë nga neni 188 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.5940/15 e dt.16.11.2016 pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me datë 04.02.2019 në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Ibrahim Fejza, të akuzuarëve, të njejtën ditë në mungesë të palëve mori dhe publikimisht shpalli aktgjykimin ndërsa me dt.08.02.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit,

- I. **M. A.**, nga i ati A. dhe nëna Z., mbiemri i vajzërisë së nënës R., i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim rr. "...", Komuna e P., ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, i martuar, baba i 3 (tre) fëmijëve, sipas të dhënave penale të kësaj gjykate nuk ka qenë i dënuar më parë dhe ndaj tij zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovë.

- II. **A.A.**, nga i ati A. dhe nëna Z., mbiemri i vajzërisë së nënës R., i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim rr. "...", Komuna e P., ka të kryer shkollën fillore, me profesion automekanik, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal të identifikimit: *numri personal...*, i martuar, baba i 2 (dy) fëmijëve, sipas të dhënave penale të kësaj gjykate ka qenë i dënuar më parë dhe ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptar-Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovë.

L I R O H E N G A A K U Z A

Sepse:

Më dt. 31.08.2015, rreth orës 14:15 minuta te servisi i veturave "B." në Rr. Magjistranja afër Ypsilonit në P., i dëmtuari A.S. e kishte dërguar Kombibusin e tij të tipit "Mercedes 207" për ta rregulluar tek servisi "B.", të pandehurit A.A. dhe M.A. pas një mosmarrëveshje lidhur me një borxh të ma hershëm që kishte babai i të dëmtuarit H.S., fillojnë fjalosjen dhe sharjet e më pas i pandehuri M.A. e ka goditur me një send tjetër që mund ti shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndeti-shufër të metaltë, kurse i pandehuri A.A. me grushte e ka godit nëpër pjesë të trupit të dëmtuarin A.S. me ç'rast të dëmtuarit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore.

Me çka secili veç e veç në bashkveprim kishte për të kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Për shkak se nuk është provuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Shpenzimet e procedurës penale dhe paushalle bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari A.(H.) S. nga fshati M., Komuna e P. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ushtruar aktakuzën, PP.II.nr.5940/15 e dt.16.11.2016, kundër të akuzuarëve M.A. dhe A.A. që të dy me vendbanim në rr. "...", Komuna e P. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 04.10.2018, seancat e shqyrtimit gjyqësor me datat 10.01.2019, dhe 04.02.2019 në të cilën seancë ka prezantuar Prokurori i Shtetit Ibrahim Fejza dhe të akuzuarit.

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar pas propozimit të prokurorit të shtetit, konform nenit 36 të KPRK-së, me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës penale, me Aktvendim e ka veqar procedurën penale për të pandehurin Petrit Sylejmani për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak se i njëjti gjendet jashtë shtetit.

Prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës në seancën e shqyrtimit fillestar ka bërë precizimin e veprës penale ashtu që duhet të jetë: në bashkveprim kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit të akuzuarit u deklaruan të pa fajshëm për veprën penale për të cilën akuzohen.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 04.02.2019, gjykata konform neni 258 par. 1 dhe 2 si dhe nën par 2.3 ka marr aktvendim me të cilin ka ndaluar marrjen në pyetje të dëmtuarit-dëshmitarit A.S., për shkak se është e pa mundur dhe i pa arritëshëm pasi që i njëjti gjendet jashtë shtetit në Gjermani, sipas informatës së Stacionit Policor në Podujevë të dt. 04.02.2019.

Prokurori shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi: Deklaratat e sotme të dhëna në këtë shqyrtim gjyqësor nga ana e të pandehurëve M. dhe A.A. bien ndesh me deklaratat e po të njëjtëve të dhëna në polici me dt. 31.08.2015, dhe kjo nga ana e tyre pa mëdyshje bëhet me qëllim ti ikun fajsisë dhe përgjegjësisë së tyre penale. Nga ana tjetër ekspertiza mjeko-ligjor e dt. 18.10.2016 nga Dr. M.G. tregon qartë se në ditën kritike A.S. nga ana e të pandehurëve kishte pësuar

lëndime të lehta trupore dhe mbetem në tërësi pranë aktakuzës kundër të pandehurëve M.A. dhe A.A. për veprën penale për të cilën akuzohen duke i propozuar gjykatës që të njëjtit ti shpall fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit.

I akuzuari M.A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare veç të tjerash deklaroi: Në ditën kritike rastësisht kam shkuar te A. në Servis, aty kam takuar dy persona të cilët nuk i njoh, për disa momente unë kam shkuar në wc, kur dola aty i pash policët të cilët na ftuan të shkojm në stacion policor të japim deklaratë, dhe nuk është e vërtet që unë kam goditur dikë dhe nuk e kam par A. që është rrahur me dikë, për këtë nuk e ndjej vetën fajtor dhe kërkoj nga gjykata që të më liroj nga aktakuza.

I akuzuari A.A. në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare veç të tjerash deklaroi: Ditën kritike në servis kam ardhur dy persona, me emra si njoh vetëm si figurë me një mercedes furgon 207, për ta rregulluar, unë e kontrollova dhe i thashë ky motorr ka bllokuar dhe ska mundësi për të bërë asgjë, të njëjtit të acaruar mu drejtuan duke më thënë ti spo don me na shërby dhe ti nuk më njeh se kush jam unë, njëri prej tyre e ktheu kerrin disi në shpejtësi në mënyrë të vrullëshme dhe e lidhi kombin me sajlë dhe e filloj të ngreh pa vozitës fare dhe unë ju afrova e thashë nuk mundesh kështu se mundesh të mi dëmtosh veturat e myshterive tjerë, i'a mshela dyert e puntoris dhe kemi prituri deri sa kam ardhur policia, për këtë nuk e ndjej vetën fajtor dhe kërkoj nga gjykata që të më liroj nga aktakuza, kam qenë në vendim tim të punës dhe nuk e ndjej vetën fajtor.

Gjykata gjatë procedurës së provave ka lexuar: Ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. M. G. e datës 18.10.2016 për të dëmtuarin me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike.

Gjykata pas propozimit të prokurorit të shtetit, në munges të dëmtuarit-dëshmitarit, në shqyrtimin gjyqësor lexoj deklaratën e tij të dhënë në polici me dt. 31.08.2015.

Gjykata edhe pse ka lexuar nuk ja fali besimin deklaratës të dëmtuarit-dëshmitarit të dhënë në polici, për shkak se të akuzuarit në asnjë fazë të procedurës penale nuk janë ballafaquar me të dëmtuarin-dëshmitarin A.S.

Për gjykatën është tërësisht e pa pranuar ekspertiza mjeko-ligjore për të dëmtuarin-dëshmitarin, e cila është konstatuar duke u thirrur në raportin mjekësor me numër protokollit 832 të dt. 31.05.2015 të lëshuar nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Podujevë, ndërsa vepra penale për të cilën akuzohen të akuzuarit ka ndodhur 3 (tre) muaj më vonë gjegjësisht me dt. **31.08.2015**.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Gjykata duke pasur në konsideratë nenin 7 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata, prokurori i shtetit dhe policia janë të detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i vërtetojnë faktet të

cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve të ligjshme dhe me përkujdesje të vërtetojnë faktet kundër të pandehurëve dhe në favor të tyre dhe bazuar në nenin 361 par 1 dhe 2 të KPPRK-së, ku përcaktohet se gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor dhe detyrohet të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të nxirret përfundim nëse fakti konkret është provuar.

Gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe deklaramit nga ana e të akuzuarëve, ka ardhur në përfundim se nuk ka prova të mjaftueshme, gjegjësisht të besueshme dhe të sigurta se të akuzuarit kan kryer veprën penale e cila ju vihet në barrë nga se me asnjë provë nuk janë provuar veprimet inkriminuese të akuzuarëve, si dhe duke u bazuar në nenin 3 par. 2 të KPPRK-së, ku është përcaktuar mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen konkrete interpretohen në favor të akuzuarëve, andaj provat e siguruara nga prokuroria nuk janë të mjaftueshme për ta vërtetuar dyshimin e bazuar mirë se të akuzuarit M.A. dhe A.A. e kan kryer veprën penale për të cilën akuzohen dhe në mungesë të provave tjera bindëse vendosi me aktgjykim lirues në kuptim të nenit 364 par.1 nënpar 1.3 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në bazë të nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontestin civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 3 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 par.1 nënparagrafi 1.3 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.1142/16 të dt.08.02.2019

Zyrtare Ligjore
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.